


# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6292  
E premte, 16 prill 2021  
çmimi 0.40 €

## Gastronomia rifillon punën më 19 prill

FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KËRKOHEM HARTIMI I NJË PLATFORME SHTETËRORE PËR DIALOGUN ME SERBINË

FAQE 4-5

# DIALOGU ME SERBINË S'DUHET TA GJEJË KOSOVËN TË PAPËRGATITUR

Shoqëria civile ka bërë me dije se vazhdimi i dialogut me Serbinë nuk duhet ta gjejë Kosovën pa një platformë shtetërore për dialogun. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë ftuar udhëheqësit e institucioneve të Kosovës që sa më parë ta përgatitin këtë dokument, në të cilin do të duhej të artikulohej mirë kërkesat e Kosovës lidhur me këtë proces. Gjithashtu, ata kanë kërkuar arritjen e konsensusit të gjerë politik në vend për dialogun. Sipas tyre, me këtë rast do të forcohej pozicioni i Republikës së Kosovës në këtë proces



## AKTUALE



LIDERËT E KOSOVËS PREMTOJNË  
ANGAZHIM MAKSIMAL  
PËR TË PAGJETURIT F. 6

KËRKOHEM BASHKËPUNIM PËR  
DIGJITALIZIMIN E KUJDESIT  
SHËNDETËSOR F. 7

KMDLNJ-ja: TË BURGOSURIT NË  
KOSOVË MERITOJNË MË SHUMË  
VËMENDJE NGA SHTETI F. 6

## EKONOMI



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
ANULON TENDERIN  
44 MILIONËSH PËR  
MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE F. 8

RIZVANOLLI E KOSNETTI  
DISKUTUAN PËR SFIDAT  
NË SEKTORIN E ENERGJISË F. 9

## SPORT

ROGOVA: DRENICA E SIGURON  
MBIJETESËN PA 'PLAY-OFF' F. 12

## PETRIT AJETI EMËROHET DREJTOR I AKI-së

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, kanë emëruar të enjten Petrit Ajetin drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ajeti ka mbi 15 vjet përvojë pune në institucionet publike dhe private në fushën e sigurisë. Vetëm në gjashtë vjetët e fundit në AKI janë ndërruar tre drejtorë. I vetmi që ka përfunduar një mandat të plotë ka qenë drejtori i parë, Bashkim Smakaj, i cili ishte emëruar në këtë pozitë në shkurt të vitit 2009

FAQE 3



NË 24 ORËT  
E FUNDIT, 17  
TË VDEKUR  
NGA COVIDI NË  
KOSOVË

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## ShBA-ja do të vendosë sanksione ndaj Ruisë

UASHINGTON, 15 PRILL - Shtetet e Bashkuara pritet të shpallin sanksione ndaj zyrtarëve dhe subjekteve ruse. Për shkak të ndërhyrjes në zgjedhjet amerikane dhe një sulmi kibernetik ndaj institucioneve qeveritare dhe korporatave amerikane, rreth 30 njësi ekonomike ruse do të përballen me sanksione, raporton "Reuters" dhe "Bloomberg", duke cituar burime të pidentifikuara. Sanksionet shënjestrojnë dhjetëra individë, duke përfshirë zyrtarë të inteligjencës ruse.

Masa do të përfshijë edhe dëbimin deri 10 zyrtarëve dhe diplomatëve rusë.

Ka disa javë që administrata e presidentit Joe Biden ka dhënë sinjale se po përgatit një përgjigje ndaj shkeljes së sigurisë kibernetike.

Zyrtarët e inteligjencës amerikane dhe kompanitë e teknologjisë kanë thënë se sulmi kibernetik që u zbulua në dhjetor të vitit 2020 mund të ishte bërë nga ana e hakerëve rusë. Por, Moska e ka mohuar akuzën.

Nga sulmi kibernetik janë prekur



të paktën nëntë agjenci qeveritare, përfshirë Departamentin e Thesarit, atë të Drejtësisë dhe të Tregtisë si dhe 100 ndërmarrje private.

Sanksionet, gjithashtu, kanë për qëllim hakmarrjen për ndërhyrjen e pretenduar gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020.

Një vlerësim i agjencive të inteligjencës amerikane tha se me shumë gjasë presidenti rus Vladimir Putin dhe qeveria ruse autorizuan dhe drejtuan një përpjekje për të ndikuar në zgjedhjet amerikane më 2020.

## Franca u bënë thirrje qytetarëve të saj të largohen nga Pakistani

PARIS, 15 PRILL - Franca u bëri thirrje të gjithë qytetarëve të saj në Pakistan që të largohen nga ky vend përkohësisht për shkak të protestave të dhunshme kundër Francës. Në një e-mail të siguruar nga agjencia e lajmeve AFP, Ambasada Franceze në Islamabad paralajmëroi për "kërcënime serioze ndaj interesave të Francës në Pakistan".

Dy oficerë të policisë u vranë këtë javë gjatë përleshjeve të reja me protestuesit.



Protestat kanë shpërthyer disa muaj më herët, pasi një revistë franceze ka publikuar karikaturat e profetit Muhamed. Qeveria e presidentit francez, Emmanuel Macron, e ka mbrojtur të drejtën e revistës për t'i publikuar karikaturat, duke shkaktuar zemërim në Pakistan - vend me shumicë myslimane.

Përshkrimi i profetit Muhamed konsiderohet si një gjë tabu në islam dhe fyese për shumë myslimanë.

Protestat u përshkallëzuan këtë javë, pasi Qeveria pakistaneze arrestoi Khadim Hussain Rizvin, udhëheqës i partisë radikale Tehreek-e-Labaik Pakistan, e cila kërkoi dëbimin e ambasadorit francez. Kjo parti, në të kaluarën, ka nxjerrë turma të mëdha njerëzish në rrugë, për të protestuar për çështje të blasfemisë.

Sipas ligjit në Pakistan, ata që shpallen fajtorë për fyerjen e profetit Muhamed mund të përballen me dënim me vdekje.

## Blinkeni, në vizitë të paparalajmëruar në Afganistan

KABUL, 15 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, bëri një udhëtim të paparalajmëruar në Kabul për t'i njoftuar zyrtarët atje me planet e ShBA-së për tërheqjen e trupave deri më 11 shtator. Vizita e Blinkenit vjen disa orë pas njoftimit të presidentit amerikan, Joe Biden, se ai do t'i japë fund luftës më të gjatë të ShBA-së, duke i kthyer në shtëpi 2 500 trupat e mbetura amerikane në Afganistan.

Blinken takoi presidentin afgan Ashraf Ghani dhe zyrtarë të lartë amerikanë në Kabul. "Me vizitën time dua ta demonstroj përkushtimin e vazhdueshëm të ShBA-së ndaj Republikës Islamike dhe popullit të Afganistanit", ka thënë Blinken pas takimit me Ghanin. "Partneriteti po ndryshon, por vetë partneriteti është i qëndrueshëm. Ne e respektojmë vendimin dhe do t'i përshtatim përparësitë tona",

ka theksuar ai. Një ditë më herët, edhe NATO-ja njoftoi se 7 000 ushtarët e saj joamerikanë në Afganistan do të largohen po ashtu nga ky vend, brenda disa muajsh. NATO, e udhëhequr nga ShBA-ja, ka ndërhyrë ushtarakisht në Afganistan në vitin 2001, pak javë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit në ShBA. Që nga ajo kohë mbi 2 300 ushtarë amerikanë kanë humbur jetën në luftën në Afganistan.



## Turqia thotë se luftanijet e ShBA-së nuk kaluan në Detin e Zi

ANKARA, 15 PRILL - Shtetet e Bashkuara kanë anuluar vendosjen e dy anijeve luftarake në Detin e Zi, thanë zyrtarët dhe media turke. Burimet diplomatike turke thanë se kalimi i anijes së parë përmes Ngushticës së Bosforit ishte planifikuar për të mërkurën, mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi. Paralajmërimet për dërgimin e luftanijeve ishin bërë pas rritjes së tensioneve mes Ruisë dhe Ukrainës.

Javën e kaluar Turqia njoftoi se ishte informuar përmes kanaleve diplomatike se dy anije luftarake të ShBA-së "do të kalojnë drejt Detit të Zi" dhe do të qëndrojnë në rajon deri më 4 maj. Nuk ka pasur asnjë konfirmim zyrtar nga Uashingtoni për vendosjet e planifikuara ose për anulimin e tyre.

Ambasada e ShBA-së në Ankara kishte njoftuar Ministrinë e Jashtme të Turqisë për lëvizjen, thanë burimet. Agjencia



shtetërore e lajmeve "Anadolu" e Turqisë më vonë njoftoi se asnjë njoftim i ri nuk ishte dërguar në Ankara për vendosjet të mundshme në datat e mëvonshme.

Zyrtarët amerikanë thanë se Turqia mund të ketë

keqkuptuar njoftimin fillestar, pasi vendosja e anijeve nuk ishte konfirmuar kurrë. Sipas tyre, Shtetet e Bashkuara shpesh e njoftojnë Turqinë për qasje të mundshme në Detin e Zi. Por, një kërkesë e tillë nuk do të thotë domosdoshmërisht anijet e saj do të kalojnë andej. Sipas Konventës së Montreux që daton nga viti 1936, Uashingtoni është i obliguar t'i tregojë 15 ditë përpara Ankarasë se do të dërgojë anije luftarake nëpër ngushticat e

Bosforit dhe Dardaneleve. Kushtet e traktatit lejojnë që anijet luftarake të huaja të qëndrojnë në Detin e Zi për 21 ditë.

Anijet e Marinës Amerikane veprojnë vazhdimisht në rajon në mbështetje të Ukrainës, e cila në lindje të vendit ka luftuar me forcat e mbështetura nga Rusia që kur një revolucion i vitit 2014 rrëzoi udhëheqësin pro-Moskës në Kiev. Rusia aneksoi Gadishullin e Krimesë të Ukrainës.

MË NË FUND AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË (AKI) BËHET ME DREJTOR TË RI

# Petrit Ajeti emërohet drejtor i AKI-së



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, kanë emëruar të enjten Petrit Ajetin drejtor të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ajeti ka mbi 15 vjet përvojë pune në institucionet publike dhe private në fushën e sigurisë. Vetëm në gjashtë vjetët e fundit në AKI janë ndërruar tre drejtorë. I vetmi që ka përfunduar një mandat të plotë ka qenë drejtori i parë, Bashkim Smakaj, i cili ishte emëruar në këtë pozitë në shkurt të vitit 2009

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, kanë emëruar të enjten Petrit Ajetin drejtor të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ky emërim është bërë në përputhje me kompetencat kushtetuese të presidentes dhe kryeministrit të Kosovës. "Petrit Ajeti ka lindur në Gjilan më 11 tetor 1981. Shkollën fillore dhe të mesme Gjimnazin Matematiko-Natyror i ka mbaruar në Gjilan. Në vitin 2001 ka vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake 'Skënderbej' në Tiranë. Gjithashtu, ka kryer studimet në nivelin baçelor në Shkencë Politike në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina', bëhet me dije në njoftimin e Presidencës. Më tej në njoftim theksohet se: "Ajeti ishte bursist i programit

të bursave pasuniversitare të BE-së Young Cell Scheme', përmes të cilit mbaroi studimet e nivelit master në fushën e Arteve në Përgjegjësinë Sociale të Korporatave në Universitetin Metropolitan të Londrës në Mbretërinë e Bashkuar. Z. Ajeti ka ndjekur disa programe ndërkombëtare në kuadër të zhvillimit profesional në fushën e Sigurisë. Paralelisht me edukimin z. Ajeti ka qenë aktiv në fushën e sigurisë". Bëhet me dije se Petrit Ajeti ka mbi 15 vjet përvojë pune në institucionet publike dhe private në fushën e sigurisë. "Nga viti 2013 ka punuar në kapacitete të ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës si zyrtar për koordinim të investimeve të huaja të mbrojtjes dhe ushtrues detyre i shefit të sektorit për integrim euroatlantik dhe, së fundi, shef i Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm. Çështjet kryesore ku ai është angazhuar

përfshijnë planifikimin, programimin, buxhetimin dhe ekzekutimin në fushën e mbrojtjes. Gjithashtu, z. Ajeti ka qenë anëtar i grupit punues ndërinstitucionale për hartimin e Strategjisë së parë të Mbrojtjes. Nga viti 2007 deri në vitin 2010 z. Ajeti ka punuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në cilësinë e zyrtarit të lartë në Departamentin për Hartimin e Politikave të Sigurisë së Brendshme si dhe në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion. Ai ka përvojë ndërkombëtare në fushën e sigurisë si kontraktor civil për ushtrinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bazat ushtarake në Afganistan dhe Kosovë. Angazhimi në këto detyra z. Ajeti i ka ofruar një këndvështrim të shkëlqyeshëm të çështjeve që duhen trajtuar nga institucionet e sigurisë, përfshirë kërcënimet ekzistenciale", është theksuar

në njoftimin e Presidencës. Petrit Ajeti flet rrjedhshëm gjuhën angleze. Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë. Petrit Ajeti është vëlla i dëshmorit Alban Ajeti. Vetëm në gjashtë vjetët e fundit në AKI janë ndërruar tre drejtorë. I vetmi që ka përfunduar një mandat të plotë ka qenë drejtori i parë, Bashkim Smakaj, i cili ishte emëruar në këtë post në shkurt të vitit 2009. Një vit pas riemërimit, më 2015, ai kishte dhënë dorëheqje, duke u zëvendësuar nga Agron Selimaj. Ky i fundit, po ashtu, kishte dhënë dorëheqje dy vjet më vonë, më 2017. Në vend të tij, më 2017, u emërua Driton Gashi, të cilit iu kërkua të lironte detyrën vetëm një vit pas marrjes së detyrës

për shkak të skandalit me arrestimin dhe dëbimin e gjashtë shtetasve turq. Që atëherë, në pozitën e drejtorit të AKI-së ishte emëruar Kreshnik Gashi, të cilit, po ashtu, iu kërkua largimi nga ky post në dhjetor të vitit të kaluar. Në bazë të ligjit në fuqi, drejtori i AKI-së i përgjigjet drejtpërdrejt kryeministrit. Po sipas këtij ligji, drejtori i AKI-së shërben si këshilltar i presidentit dhe kryeministrit për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës; njofton presidentin dhe kryeministrin për aktivitetet e AKI-së dhe ofron informata për presidentin dhe kryeministrin sa i takon sigurisë.

## Shefi i BE-së në Kosovë mirëpret emërimin e Ajetit në krye të AKI-së

Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, është shprehur i lumtur pas emërimit të drejtorit të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, Petrit Ajeti. "I kënaqur tek shoh që një i diplomuar në programin e bursave të BE-së 'Young Sell Schem' është emëruar drejtor i AKI-së. Të diplomuarit në 'Young Sell Scheme' kanë potencial të madh. Jam i lumtur që ata kontribuojnë në kapacitetet institucionale të Kosovës", ka shkruar Szunyog në "Twitter".



KËRKOHET HARTIMI I NJË PLATFORME SHTETËRORE PËR DIALOGUN ME SERBINË

## Dialogu me Serbinë s'duhet ta gjejë Kosovën të papërgatitur

Shoqëria civile ka bërë me dije se vazhdimi i dialogut me Serbinë nuk duhet ta gjejë Kosovën pa një platformë shtetërore për dialogun. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë ftuar udhëheqësit e institucioneve të Kosovës që sa më parë ta përgatitin këtë dokument, në të cilin do të duhej të artikulohehin mirë kërkesat e Kosovës lidhur me këtë proces. Gjithashtu, ata kanë kërkuar arritjen e konsensusit të gjerë politik në vend për dialogun. Sipas tyre, me këtë rast do të forcohej pozicioni i Republikës së Kosovës në këtë proces

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 15 PRILL - Shoqëria civile ka kërkuar nga udhëheqësit e institucioneve të Kosovës që ta përgatitin platformën shtetërore për dialogun me Serbinë para takimit të palëve në Bruksel. Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se për dialogun me Serbinë, Kosova duhet të përgatitet mirë.

Instituti Demokratik i Kosovës

(KDI) ka vlerësuar se vazhdimi i dialogut me Serbinë nuk duhet ta gjejë Kosovën pa strategji dhe platformë. "KDI-ja i bën thirrje kryeministrit Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani si bashkudhëheqës të politikës së jashtme, njëherësh edhe procesit të dialogut me Serbinë, që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj çështjeje. Vazhdimi i dialogut nuk duhet ta gjejë Kosovën të papërgatitur, pa plan dhe pa qartësi rreth këtij procesi", është komunikatën e

këtij instituti. Sipas KDI-së, në këtë dokument do të duhej të artikulohehin të gjitha kërkesat e Kosovës në këtë proces. "KDI-ja kërkon nga qeveria që, në koordinim me Presidencën, sa më parë ta përgatitin strategjinë dhe platformën shtetërore për dialogun me Serbinë, ku artikulohehen qartë e argumentohen mirë kërkesat e Kosovës lidhur me këtë proces. Konsolidimi i këtyre dokumenteve nuk duhet ta anashkalojë rolin mbikëqyrës të

Kuvendit në këtë proces të rëndësishëm shtetëror, duke garantuar bashkërendim të institucioneve, gjithëpërfshirje, llogaridhënie dhe transparencë", ka vlerësuar KDI-ja.

Edhe Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se Kosovës i duhet një platformë për dialog. Ai ka thënë për "Epokën e re" se për një dokument të tillë Kuvendi i Kosovës ka miratuar disa rezoluta. "Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezoluta, ka diskutuar dhe debatuar lidhur me nevojën që Kosova ta ketë platformën lidhur me dialogun me Serbinë. Për më tepër, përdërisa dialogu Kosovë - Serbi synon një marrëveshje finale të detyrueshme dhe dallon nga dialogu teknik i 10 vjetëve të fundit, Kuvendi i Kosovës duhet të marrë rol mbikëqyrës më të madh në raport me qeverinë

dhe ekipin negociues duke përcaktuar kornizën e temave të dialogut", ka thënë Miftaraj.

**Kërkohet ndërtimi  
i konsensusit nacional  
për dialogun**

Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se Kosova duhet të arrijë edhe një konsensus të brendshëm nacional rreth dialogut me Serbinë. KDI-ja i ka ftuar bartësit e këtij procesi, që krahas hartimit të strategjisë dhe platformës për dialogun, të ndërmarrin hapa konkretë drejt arritjes së konsensusit të gjerë politik për dialogun, me qëllim për ta forcuar pozicionin e Republikës së Kosovës në këtë proces. "Në këtë drejtim, kryeministri dhe presidentja, konform përgjegjësi të tyre kushtetuese, duhet ta iniciojnë dhe t'i kontribuojnë ndërtimit të

konsensusit politik lidhur dialogun. Ndërsa subjektet opozitare duhet të jenë të përgjegjshme për arritjen e konsensusit për këtë çështje të interesit shtetëror, duke treguar përkushtim dhe konstruktivitet për tejkalimin e pengesave për arritjen e pajtueshmërisë", ka vlerësuar KDI-ja.

Kurse Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi ka deklaruar se për këtë çështje të rëndësishme Kosova do të duhej të arrijë në konsensus nacional. Ai ka thënë se vetëm një konsensus i tillë do të garantojë zbatimin e çdo marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi. "Dialogu Kosovë - Serbi tejkalon partitë politike në pushtet dhe do të duhej koordinim, bashkëpunim dhe përfshirje edhe të opozitës. Vetëm një qasje e tillë do të garantonte edhe zbatimin e çdo marrëveshje që do të arrihej", është thënë Miftaraj.

Dy ditë më parë komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, i ka shkruar letër kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të cilit i ka kërkuar rinisje të shpejtë të dialogut për normalizim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kthimi i perspektivës evropiane të Kosovës në një realitet për qytetarët e saj gjithashtu kërkon një vazhdim të shpejtë të dialogut Beograd - Prishtinë të lehtësuar nga BE-ja dhe normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë", është thënë në letrën e Varhelyit. Sipas tij, një gjë e tillë është thelbësore për rrugën përkatëse evropiane të Kosovës dhe Serbisë dhe për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal.

Komisionari i BE-së ka thënë se mezi pret që të takohet me kryeministrin Kurti.

Ditë më parë përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, ka thënë se takimi i parë midis kryeministrit të ri të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vučić, pritet të ndodhë brenda disa javësh. Ai ka treguar se ka marrë garanci se udhëheqësit e të dy vendeve janë të gatshëm ta vazhdojnë dialogun. "Mendoj se takimin e parë mund ta presim shumë shpejt, pa shtyrje të panevojshme. Kosova, ashtu siç jemi marrë vesh edhe me zotin Kurti, duhet ta përfundojë krijimin e institucioneve. Ka mbetur tani edhe zgjedhja e presidentit dhe përgatitja e ekipit të ri. Pas kësaj, presim që ata të jenë të gatshëm. Ai më ka thënë se është i gatshëm të vijë në Bruksel për t'u takuar me presidentin Vučić. Po ashtu, Vučić më ka thënë se është i gatshëm të vijë kurdo që të ftohet", ka deklaruar Lajčak.

## Shkarravitje kufijsh të rinj në Ballkan

Norbert MAPPES-NIEDIEK

"Zgjidhje" titullohet paragrafi i një "non-paper" që kryeministri sloven Janez Janša u dorëzoi disa personave të përzgjedhur në BE disa muaj më parë. Ajo që vijon më tej duket sikur po lexon ndonjë dokument nga Kongresi i Berlinit i vitit 1878, kur Otto von Bismarck, Lord Salisbury dhe Princ Gorçakovi u ulën së bashku përpara hartës së Ballkanit - dhe brenda një muaji vendosën me dorë të lirë për fatin e kombeve.

Për pikën "a) Bashkimi i Kosovës dhe i Shqipërisë" në letër shkruhen katër rreshta. Për pikën "b) Bashkimi i pjesës më të madhe të Republikës Srpska me Serbinë" vetëm tre. Janša dëshiron të rishikojë edhe konturet e Kroacisë fqinje: "c) Çështja kombëtare Kroate mund të zgjidhet" ose, "duke bashkuar kantonet kryesisht kroate në Bosnjë-Hercegovinë me Kroacinë" ose duke i dhënë "Pjesës kroate" të vendit një "status të veçantë" - "bazuar në modelin e Tirolit të Jugut".

### Po boshnjakët?

Ata që mbeten janë boshnjakët, që përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit. Sipas planit të Janša atyre mund t'u jepet "një shtet që funksionon në mënyrë të pavarur" dhe "për të cilin ata duhet të marrin përgjegjësinë e plotë". Nëse boshnjakët nuk dëshirojnë, atëherë nuk kanë pse të hyjnë në Evropë: "Ata mund të votojnë në një referendum për një të ardhme në BE ose jo në BE apo Turqi." Boshnjakët muslimanë janë "përkohësisht" në favor të anëtarësimit në BE. "Por nëse kaosi vazhdon dhe me rritjen e ndikimit të Turqisë dhe islamizmit radikal," thotë Janša, "situata mund të



përkeqësohet në dekadën e ardhshme në mënyrë drastike".

Tani për tani për këto ide duhet "heshtur" derisa për "planin" të bihet dakord me vendimmarrësit" në rajon dhe në bashkësinë ndërkombëtare.

### Letër ogurzezë

Dokumenti shkaktoi tronditjet e para edhe përpara se të bëhej publik të mërkurën në mbrëmje nga portali i djathtë i sloven "necenzurirano.si". Rishikimi i kufijve, që është tema e kësaj letrë ogurzezë, është tabuja e madhe e Ballkanit: një kërcënim i madh për të cilin askush nuk flet. Ministri i Jashtëm i Kroacisë Gordan Grlj? Radman shkoi në Sarajevë dhe qetësoi shpirtrat: Kroacia është në çdo rast pro integritetit të vendit fqinj, për ekzistencën e "letrës fantazmë" slovene nuk ka "asnjë provë". Një nga personat të cilëve u ishte drejtuar letra, Presidenti i Këshillit të BE-së Charles Michel, tha se ai nuk mund ta "konfirmonte" se e kishte marrë atë -gjë që nëse flasim me rigorozitet, nuk do të thotë se vërtet nuk e ka marrë.

### Dy koncepte kundërshtarë

Prej tridhjetë vjetësh në rajon përballesh me njëri-tjetrin dy koncepte kundërshtarë. Sipas njërit, që është mbisundues,

kufijtë mbeten të paprekur; dhe çdo vend zhvillon strukturat e veta demokratike në të cilat kanë vend edhe pakicat etnike. Sipas konceptit tjetër, për të cilin përgjithësisht nuk flitet, kufijtë duhen vendosur sipas kriterëve etnike, dhe sunduesit përkatës mund ta qeverisin familjen e tyre kombëtare pa i shqetësuar askush. Nëse shtetet janë "etnikisht të pastër" nuk ka më vend për "kaosin" me të drejtat e pakicave, institucionet apo proceset demokratike të votimit.

### Ndikimi i Orbanit

Slovenia merr Presidencën e Këshillit të BE më 1 korrik dhe siç është zakon, kryeministri Janša skicoi në dhjetor në Bruksel, prioritetet e tij. Ballkani është në fokus të tyre. Janša është mjaft i lidhur me Viktor Orbanin, homologun e tij në Hungarinë fqinje. Orbani financon mediat e djathta, që raportojnë pro kryeministrit Janša në Slloveni dhe përmes Lubjanës, bën të njëjtën gjë në Maqedoninë e Veriut, ish-kryeministrit të së cilës Nikola Gruevski, i cili është dënuar për korrupsion, Hungaria i ka dhënë azil.

Ishte Orbani ai që instaloi të besuarin e tij Olivér Varhelyi si komisionerin e ri të zgjerimit të BE. Në këtë funksion hungarezi merret kryesisht me mundësitë e pranimit të Serbisë fqinje në BE. Në këtë rrjet, nisma dhe

"non-papers" të tilla nuk bien më në vesh të shurdhër.

### Ndikim i kufizuar

Janša nuk ka gjasa që t'i çojë në Bruksel vërtet përpara ëndrrat e miqve të tij hungarezë dhe serbë. Kreu i qeverisë slovene nuk gëzon më asnjë simpati që nga prezantimi i tij e fundit para Parlamentit Evropian. Kur eurodeputetët i kërkuan t'u përgjigjej pyetjeve për lirinë e medias në Slloveni, ai këmbënguli që të shfaqte një film; dhe kur parlamenti nuk e pranoi këtë, Janša thjesht shkëputi lidhjen e internetit. Ashtu sikurse në rastin e komisionerit hungarez Várhelyi, i cili në Bruksel është kryesisht i menjëhershëm, strukturat komplekse të BE e bëjnë gjithashtu të mundur neutralizimin e Presidencës slovene të Këshillit.

### Jo thjesht fantazi nxënësi të shkollës së mesme

Sidoqoftë idetë e paraqitura në "non-paper" nuk mund të konsiderohen thjesht fantazi të një nxënësi të shkollës së mesme. Para rreth tre vjetësh Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić ndeshi në miratim e vullnet të mirë kur shprehu dëshirat e tij për rregullimin e kufijve në Evropë sipas parimeve etnike: një përfaqësues socialdemokrat për punët e jashtme, një komisioner demokristian për zgjerimin dhe një president i gjelbër i një shteti bëri fushatë për rishpërndarjen e territoreve midis Serbisë dhe Kosovës. Sa më larg nga rajoni që janë hobby-strategët e Evropës, aq më i madh është tundimi për ta prerë njënjën e supozuar Gordiane të "konflikteve etnike" të keqkuptuara me një goditje të vetme. Vetëm ndonjë Princ Bismarck nuk po duket aktualisht gjekundi./ DW

## Rama paralajmëron mbërritjen e mbi 90,000 dozave AstraZeneca

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, paralajmëroi të enjten se në këtë vend do të arrijnë edhe 90,800 vaksina AstraZeneca kundër koronavirusit.

Në një postim në Facebook, Rama tha se dozat e reja do të arrijnë në fundjavë.

"Shqipëria do të vijojë të qëndrojë në vendet e para të klasifikimit evropian për shpejtësinë e vaksinimit dhe ne do ta tejkalojmë objektivin e 500

mijë të vaksinuarve brenda majit", shkroi Rama.

Shqipëria ka filluar vaksinimin kundër koronavirusit në fillim të muajit janar, duke u dhënë përparsi punonjësve shëndetësorë.

Më 28 mars, vendi ka nisur vaksinimin masiv, fillimisht në Tiranë, për të vazhduar më pas në qytete të tjera.

Rama po ashtu tha se numri i të vaksinuarve në Shqipëri, të



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, duke u vaksinuar me vaksinën Pfizer/BioNTech. Janar, 2021.

enjtën, kalon 300-mijëshin. Përveç vaksinave të kompanisë anglo-suedeze AstraZeneca,

Shqipëria ka siguruar vaksina edhe nga prodhuesi amerikanogjerman, Pfizer/BioNTech, si dhe nga Rusia dhe Kina.

Të gjitha këto vaksina duhet të jepen në dy doza për të qenë sa më efektive.

Sipas Universitetit Johns Hopkins në SHBA, i cili ndjek të dhëna për pandeminë, Shqipëria ka konfirmuar mbi 128,000 raste me koronavirus dhe 2,331 viktima.

## Liderët e Kosovës premtojnë angazhim maksimal për të pagjeturit

Presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, dhe nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, pritën të enjten në takim nënat e personave të pagjetur nga organizata "Thirrjet e Nënave". Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës thanë se të pagjeturit e luftës mbeten "plagë e përbashkët" dhe premtuan angazhim maksimal për zbardhjen e fatit të tyre



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Presidentja Vjosa Osmani, së bashku me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, kryeministrin Albin Kurti, si dhe nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kanë pritur të enjten në takim nënat e personave të pagjetur nga organizata "Thirrjet e Nënave". Presidentja Osmani ka thënë se të pagjeturit janë plagë e përbashkët. "Për institucionet e reja gjetja e më të dashurve tuaj, vajzave dhe djemve të cilët tashmë janë të të gjithë Kosovës, është prioritet.

Përkushtohemi dhe ju premtojmë se do të punojmë pandërprerë që t'i gjejmë ata sa më parë të jetë e mundur", ka theksuar presidentja Osmani.

Kryekuvendari Glauk Konjufca ka theksuar se dhimbjen për të pagjeturit e ndajnë të gjithë. "Ashtu si deri më tani, ne të gjithë e ndajmë dhimbjen me ju. Ju keni dhënë më të dashurit tuaj dhe keni bërë sakrificën më sublime që ne sot të jemi të lirë. Andaj, do të punojmë së bashku për ta siguruar drejtësinë e vonuar", ka theksuar kryetari Konjufca. Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka

premtuar angazhim maksimal për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. "Dhimbja dhe ankthi që ju përjetoni janë të pakrahueshme. Ne do të punojmë vazhdimisht për të garantuar të drejtën tuaj për të ditur për fatin e më të dashurve tu", është shprehur kryeministri Kurti.

Në emër të shoqatës "Thirrjet e nënave", Nusrete Kumnova ka falënderuar krerët e shtetit për pritjen dhe mirëkuptimin. "Të gjithë i kemi shpresat dhe pritjet e mëdha dhe po presim me padurim që të punohet e të veprohet prej së vërteti për t'i adresuar nevojat dhe kërkesat e nënave dhe familjareve të

personave të zhdukur", ka thënë Kumnova.

Të tre liderët institucionalë garantuan se do të vazhdojnë të jenë pranë nënave dhe familjarëve të personave të pagjetur dhe se prioritet i tyre do të jetë zbardhja e fatit të tyre si një parakusht për sigurimin e drejtësisë.

## KMDLNj: Të burgosurit në Kosovë meritojnë më shumë vëmendje nga shteti

PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Që nga shpërthimi i pandemisë e shkaktuar nga Covid-19, një prej grupeve më të marginalizuara që i janë shkelur të drejtat e njeriut janë personat e privuar nga liria dhe të dënuarit që janë në vuajtje të dënimit. Kështu është thënë në një reagim të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj). Sipas KMDLNj-së, Shërbimi Korrektues i Kosovës për ta mbrojtur shëndetin dhe jetën e të burgosurve dhe stafit të këtij shërbimi ka qenë i detyruar t'i zbatojë disa masa kufizuese dhe shtrënguese për faktin se është dashur t'i respektojë rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë, përkatësisht të IKShPK-së. "KMDLNj ka vlerësuar se në situata të jashtëzakonshme siç ishte në fillim të pandemisë e që është



edhe sot, duhet të merren vendime të jashtëzakonshme e që nuk është vepruar kështu. Kështu, gjykatat kanë refuzuar kërkesat për lirim edhe për të dënuar me diagnozë terciare, me fatalitet

të pashmangshëm dhe për këtë arsye kemi pasur rritje të numrit të të dënuarve që kanë vdekur në burg brenda një kohe të shkurtër pikërisht për shkak të sëmundjeve të pashërueshme. KMDLNj disa

herë ka reaguar sikurse që edhe tani kërkon që të gjithë të dënuarve që u është mohuar e drejta e shfrytëzimit të përfitimeve për shkak të pandemisë, në rastin kur të kthehemi në një

normalitet, ato duhet t'u kompensohen, pa asnjë hezitim. KMDLNj edhe më parë ka reaguar për kriteret e Panelit për Lirim me Kusht që më shumë vështirësojnë lirinë e atyre që i kanë plotësuar kushtet se që u mundësojnë realizimin e kësaj të drejte", thuhet në këtë reagim.

KMDLNj inkurajon Ministrinë e Drejtësisë që në kuadër të reformave të premtuara, një vëmendje të veçantë t'ia kushtojë përmirësimit të kushteve për personat e privuar nga liria dhe stafit korrektues dhe administrativ, sidomos në fushën e ekzekutimeve të sanksioneve penale, përkatësisht zbatimin më efikas të mekanizmave ligjorë që rregullojnë përfitimet e të dënuarve që kanë sjellje të mira.

## Organizohet fushata "Thuaju jo qeseve të plastikës"

Prishtinë, 15 prill (ER) - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, mori pjesë të enjten në fushatën "Thuaju jo qeseve të plastikës", organizuar nga Handikos dhe The Balkan Forum. Në këtë aktivitet simbolik edhe zyrtarisht janë prezantuar

çantat e ripërdorshme të punuara tash e disa muaj nga personat me aftësi të kufizuara.

Kryeministri Kurti ka thënë se është i bindur që Kosova, shteti ynë, si shtëpia e popullit tonë, duhet ta ketë një dysheme të fortë sociale dhe një kulm solid ambiental. "Pra edhe duhet

të kujdesemi për ata të cilët janë më të varfër, më të dobët, të sëmurë apo me nevoja të veçanta, njëkohësisht edhe duhet ta kuptojmë që burimet natyrore janë të fundme dhe ato janë edhe mjedise jetësore, e jo vetëm lëndë e parë për teknologjinë", ka thënë Kurti.



# Në 24 orët e fundit, 17 të vdekur nga Covidi në Kosovë

Shtatëmbëdhjetë viktima nga koronavirusi dhe 599 raste të reja u raportuan të enjten në Kosovë. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, tri raste të vdekjes u regjistruan në Prishtinë, nga dy raste në Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Klinë, Mitrovicë dhe nga një rast në Gjakovë, Obiliq, Podujevë dhe Viti



## Kosova do ta fillojë vaksinimin e personave 75-79 vjeç

Më 16 prill në Kosovë do të fillojë vaksinimi i personave të moshës 75-79 vjeç me sëmundje kronike ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë përmes një njoftimi për media. "Për disa ditë me radhë, në Prishtinë dhe në të gjitha komunat, do të fillojë vaksinimi i personave të moshës 75-79 vjeç me sëmundje kronike sipas listës së diagnozave të pacientëve

me sëmundje kronike, të dëshmuar me raport mjekësor me rastin e paraqitjes për vaksinim", thuhet në njoftim. Ndërkohë, është duke vazhduar vaksinimi i personave mbi moshën 80 vjeç dhe i profesionistëve shëndetësorë. Kosova ka nisur procesin e vaksinimit kundër koronavirusit më 29 mars, pas sigurimit të 24 000 dozave të

vaksinës "AstraZeneca", përmes programit COVAX i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili ka për qëllim shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra. Autoritetet kanë thënë se do të pranohen edhe 76 800 doza tjera të vaksinës së "AstraZeneca" në periudhën prill-qershor dhe, deri në fund të qershorit, mbi 100 000 doza të vaksinës "Pfizer/BioNTech".

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 PRILL - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 576 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 599 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar 17 raste të të vdekurve si pasojë e Covid-19.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë tri raste (77, 66, 51 vjeç), Ferizaj dy raste (79, 63 vjeç), Gjilan dy raste (81, 70 vjeç), Kamenicë dy raste (69, 67 vjeç), Klinë dy raste (81, 68 vjeç), Mitrovicë dy raste (80, 73 vjeç), Gjakovë një rast (78 vjeç), Obiliq një rast (58 vjeç), Podujevë një

rast (63 vjeç), Viti një rast (72 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 100 135 raste nga 490 546 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 2 039 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 868 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 85 196 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 900.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 128 raste, Gjilan 63 raste, Ferizaj 62 raste, Mitrovicë 46 raste, Gjakovë 44 raste, Podujevë 38 raste, Pejë 32 raste, Fushë-Kosovë 29 raste, Vushtrri 26 raste, Lipjan 19 raste, Deçan 11 raste, Kaçanik 11 raste, Obiliq 11 raste, Prizren 11 raste, Skenderaj 11 raste, Klinë 9 raste, Leposaviq 8 raste, Drenas 7 raste, Kamenicë 6 raste, Shtime 6 raste, Istog 5 raste, Malishevë 4 raste, Suharekë 4 raste, Viti 3 raste, Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Junik, Zubin-Potok dhe Zveçan.

## Kërkohet bashkëpunim për digjitalizimin e kujdesit shëndetësor

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 PRILL - Parandalimi i sëmundjeve dhe trajtimi efikas përmes teknologjisë digjitale janë thelbësore për një shoqëri të shëndetshme, veçanërisht në këtë kohë të pandemisë. Duke marrë parasysh këtë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar forumin virtual mbi kujdesin e shëndetësisë digjitale për të diskutuar më tej për rëndësinë dhe mjedisin e sigurt të cilin e ofron kjo e fundit.

Jeta Statovci, deputete në Kuvendin e Kosovës, ka theksuar se sistemi shëndetësor duhet të adaptohet me nevojat e pacientëve. Ajo më tej ka thënë se ka pasur hapësirë të mjaftueshme për inkuadrimin e shëndetësisë digjitale në sistemin shëndetësor, mirëpo nuk është bërë edhe pse ka qenë shumë e nevojshme, veçanërisht në një gjendje të jashtëzakonshme, siç

është kjo e pandemisë.

Statovci ka rekomanduar se shteti i Kosovës mund të implementojë një sistem informativ shëndetësor si në vendet e tjera, i cili ka rezultuar efikas në këtë aspekt. "Kjo mungesë e digjitalizimit ka rezultuar me mungesën e historikut të të dhënave shëndetësore për secilin qytetar dhe kësaj të dhënash shëndetësore të sektorit publik dhe privat duhet të centralizohen në mënyrë që pacienti të ketë një tretman më efikas", ka thënë Statovci.

Drejtori ekzekutiv i Spitalit Amerikan, Igli Larashi, ka konsideruar të nevojshëm një bashkëpunim mes sektorit publik dhe privat për sektorin e shëndetësisë. Sipas tij, këto të dhëna të pacientëve që do të digjitalizoheshin duhen përfshirë në Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Larashi, për më tepër, ka rekomanduar se në mënyrë që në



Kosovë të ketë një sistem të mirëfilltë digjital, Kosova duhet të përfitojë prej përvojës së mjekëve të huaj. Sa i përket sistemit shëndetësor digjital, Armend Vokshi, drejtor menaxhues në Klinikën Amerikane, ka theksuar se Kosova nuk duhet ta kopjojë sistemin e vendeve të tjera, por duhet ta përshtatë atë sipas nevojave të vendit.

Vokshi, po ashtu, ka sugjeruar se

qeveria duhet ta rrisë ndërgjegjësimin për shëndetësinë digjitale dhe të merret me implementimin e këtij sistemi.

Më tej, ai ka bërë apel që të rritet procesi i monitorimit sa i përket zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Moderatori i këtij forumi, Dorjan Berishaj, bashkëthemelues i kompanisë softuerike Zombie Soup, vëri në pah dallimet mes sistemit shëndetësor në Kosovë

dhe atë në vendet e tjera me sistem të avancuar. Ai ka theksuar dobitë që ka ofruar përkujdesja e shëndetit digjital për kursimin e buxheteve të shteteve për trajtimin e sëmundjeve kronike. Veç kësaj, Berishaj ka theksuar ndikimin pozitiv të konsultave virtuale për trajtimin e personave me probleme psikike si rezultat i privatësisë që ofron kujdesi i shëndetësisë digjitale.

# Ministria e Infrastrukturës anulon tenderin 44 milionësh për mirëmbajtjen e rrugëve



Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Hysen Durmishi, ka bërë me dije të enjten se kanë anuluar tenderin me vlerë 44 milionë euro për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024. Po ashtu, Durmishi ka treguar se është anuluar edhe vendimi që parashihte privatizimin e shërbimit të patentëshoferëve

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 15 PRILL** - Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka mbajtur të enjten një konferencë për media, në të cilën ka folur lidhur me anulimin e dy vendimeve të marra nga kjo ministri.

Gjatë fjalës së tij para gazetarëve, zëvendësministri Durmishi ka treguar se vendimi i parë ka të bëjë me anulimin e procedurës së prokurimit për projektin: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës për vitet 2021/2022, 2022/2023 dhe 2023/2024". Vlera e parashikuar e këtij projekti ishte 44 milionë euro. "Janë dy arsye pse ne kemi anuluar këtë procedurë në këtë fazë. E para ka të bëjë me atë se ky

projekt parashihet që të jetë kontratë kornizë trevjeçare dhe nuk mund ta ndryshojmë më pasi të lidhen kontratat. Ne jemi të interesuar që të bëjmë ndryshime edhe në pozicione të paramasës e, po ashtu, edhe në kriteret teknike. Në vitet e fundit kemi një zhvillim të hovshëm të teknologjisë së ndërtimit të rrugëve, prandaj ky zhvillim duhet të jetë edhe në rrugët tona. Kjo është arsyeja e parë që ne do të intervenojmë në pozicionet e paramasës në mënyrë që edhe mirëmbajtja të jetë shumë më cilësore në vitet në vazhdim ashtu siç do të jetë shumë më cilësor secili investim në të ardhmen. Pra ne jemi të interesuar që rrugët tona të jenë më të sigurta duke përdorur teknologjinë më të avancuar për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre", ka thënë Durmishi.

Ai ka treguar edhe për arsyen e dytë që, sipas tij, ka të bëjë me

kriteret teknike të cilat duhet të ndryshojnë në mënyrë që të ketë gjithëpërfshirje dhe konkurrencë më të madhe në mes të kompanive. "Kriteret do të jenë të tilla që të kenë mundësi më shumë kompani të marrin punë dhe jo siç ka ndodhur në të kaluarën, kur paraprakisht është ditur se cilat kompani do të fitojnë. Tani kjo praktikë shumë e keqe që është vendosur nga qeveritë e kaluara dhe ministrat e kësaj ministrie do të ndryshojë përfundimisht", ka thënë Durmishi.

Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka folur edhe për anulimin e vendimit nr. 5430 të datës 21 maj 2019 dhe vendimin nr. 3992 të datës 1 qershor 2020 për themelimin e ekipit të kualifikuar për realizimin e aktiviteteve

përgatitore, implementimin dhe menaxhimin e projektit për dhënie me Partneritet Publiko-Privat të 'Shërbimit të testimit të kandidatëve për shofer, ndërtimin, funksionalizimin dhe operimin me objektet e qendrave për patentëshoferë'. Pra kemi shfuqizuar vendimin që parashihte privatizimin e shërbimit të patentëshoferëve dhe objektet e qendrave për patentëshofer", ka thënë ai. Durmishi ka thënë se nëse nuk e kemi gjendjen e mirë në sektorin e patentëshoferëve atëherë duhet që ta sanojmë këtë gjendje dhe ta përmirësojmë këtë sektor. "Ne kemi bërë veprimet e para menjëherë duke i dhënë prioritet dhe tani jemi në fazën e finalizimit të E-testimit për kandidatët për patentëshoferë. Brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore do ta funksionalizojmë E-testimin pasi që softuerin e kemi dhe kompjuterët dhe pajisjet e tjera të nevojshme do t'i kemi në ditët në vijim. E-testimi e rregullon dukshëm mbarëvajtjen e procesit të testimit sepse eliminohet faktori 'njeri' në këtë proces, rrjedhimisht eliminohen keqpërdorimet eventuale. Gjithashtu, po punojmë që edhe qendrat rajonale të

modernizohen me pajisje sa më parë që është e mundur", është shprehur Durmishi.

Ai ka theksuar se këto dy vendime që kanë marrë, përpos ndërprerjes së keqpërdorimeve dhe praktikave korruptive, kanë për qëllim edhe rritjen e sigurisë së qytetarëve në rrugë dhe komunikacion. "Pra, në njërin anë po synojmë përmirësimin e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, në anën tjetër pajisja me patentëshofer të bëhet në baza meritore e jo korruptim", ka deklaruar ai.

Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka bërë me dije se si ministri janë në fazën e analizimit të shumë vendimeve që janë marrë muajt e fundit. "Shumë prej tyre do të anulohen në ditët në vijim, pra ato vendime që nuk janë në përputhje me ligjin apo vendimet që nuk kanë asnjë mbulesë financiare e që ka shumë të tilla. Ka vendime që janë nënshkruar edhe ditën e fundit, pra ditën kur është votuar qeveria e re, vetëm se në vendim nuk shkruan ora dhe nuk dihet a është nënshkruar vendimi para apo pas votimit të qeverisë së re", ka thënë zëvendësministri Durmishi.



## Rizvanolli dhe Kosnetti diskutuan për sfidat në sektorin e energjisë

Prishtinë, 14 prill (ER) - Ministri e Ekonomisë (ME), Artane Rizvanolli, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip S. Kosnett. Ministri Rizvanolli ka njoftuar ambasadorin Kosnett

me zhvillimet në Ministrinë e Ekonomisë dhe prioritetet kryesore, përfshirë adresimin e sfidave në sektorin e energjisë dhe përmirësimin e performancës dhe llogaridhënies të ndërmarrjeve publike.


Ndër të tjera, në takim u diskutua për diversifikimin e burimeve energjetike, bashkëpunimin rajonal në sektorin e energjisë dhe rishikimin e strategjisë së energjisë, ku ShBA-ja ka qenë dhe mbetet partnerja kyçe e

Kosovës.

Ambasadori Kosnett tha se mirëpret bashkëpunimin ndërinstitucional të Qeverisë së Kosovës drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe u zotua për mbështetjen e plotë të ShBA-së në këtë drejtim.



## Gastronomia rifillon punën më 19 prill



**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 PRILL - Sektori i gastronomisë në Kosovë do të rifillojë punën më 19 prill, thuhet në një njoftim të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në të cilin njoftohet për një takim të përbashkët të kryetarëve të komunave me ministrin Elbert Krasniqi dhe atë të

Shëndetësisë, Arben Vitia. "Kemi bërë grupe punuese me përfaqësuesit e gastronomëve për të punuar rreth qasjes dhe punës së sektorit të gastronomisë në të ardhmen dhe aktiviteti i tyre do të rifillojë nga data 19 prill 2021 duke respektuar në përpikëri masat për mbrojtjen e shëndetit publik", thuhet në njoftim. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka theksuar se vendimet e

Qeverisë së Kosovës merren bazuar në rekomandimet e profesionistëve shëndetësorë, përkatësisht të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. "Duhet ta kemi të qartë se situata në institucionet shëndetësore është mjaft alarmante sepse këto institucione janë të stërngarkuara me pacientë të infektuar me Covid-19 dhe

hapësira e tyre është afër limiteve. Masat e ndërmarrja përfundojnë më 18 prill 2021 dhe më 19 prill duhen masa të reja për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19", është thënë në takim nga ministri Vitia. Masat e Qeverisë së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e koronavirusit, të cilat janë në fuqi nga data 7 prill, përfshijnë pezullimin e aktiviteteve në

shërbimet e gastronomisë, përveç shërbimeve 'merr me vete' dhe atyre me porosi. Po ashtu, është e ndaluar veprimtaria e qendrave të mbyllura tregtare, përveç shërbimeve esenciale në kuadër të tyre. Masat kanë kufizuar edhe lëvizjen e lirë prej orës 22:00 e deri në 5:00, përveç në raste urgjente. Këto masa do të jenë në fuqi deri më 18 prill.

## Murati dhe ambasadori norvegjez flasin për mbështetjen e sektorit privat

Prishtinë, 15 prill (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin ndërshtetëror dhe për gjendjen emergjente shëndetësore me pandeminë Covid-19.

Ministri Murati e ka falënderuar ambasadorin Grondahl për

projektet të cilat i ka financuar shteti norvegjez në Kosovë, me theks të veçantë projektet për sistemin e drejtësisë dhe shoqërisë civile.

Gjatë takimit Murati dhe ambasadori Grondahl diskutuan për gatishmërinë dhe masat që do të ndërmarrë Qeveria Kurti për t'i ofruar mbështetje financiare sektorit privat të ndikuar drejtpërdrejt nga vendimi i qeverisë si dhe për

planin zhvillimor dhe legjislativ të qeverisë, me theks të veçantë formalizimin e ekonomisë, luftimin e korrupsionit si dhe zbatimin e ligjit.

Ndërsa ambasadori norvegjez Jens Erik Grondahl shprehu gatishmërinë për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe theksoi se mbështetja e shtetit norvegjez do të vazhdojë edhe në të ardhmen.



## Dymbëdhjetë të arrestuar në Ferizaj për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe ryshfet

FERIZAJ, 15 PRILL (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar se në muajin tetor 2020, nga një sinjalizues i Institucionit të Komunës së Ferizajt, ka pranuar informacione se është duke u kryer vepra penale e "Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 414 si dhe "Marrja e ryshfetit" nga neni 421 dhe "Dhënia e ryshfetit" nga neni 422 nga zyrtarët e Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në

Komunën e Ferizajt. Pas vlerësimit të këtij informacioni, Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Krimeve të Rënda, së bashku me Drejtorinë e Krimeve Ekonomike në Prishtinë dhe Njësinë e Krimeve Ekonomike në Ferizaj, Prokuroria ka konsideruar se duhet të aplikohen masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Pas aplikimit të këtyre masave

disamujore, të enjten janë arrestuar dymbëdhjetë persona të dyshuar, në mesin e tyre katër teknikë të pylltarisë, katër rojtarë të pyjeve si dhe katër qytetarë nga Komuna e Ferizajt, të cilëve u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë. Prokuroria Themelore në Ferizaj brenda afatit ligjor ndaj tyre do të paraqesë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në Gjykatën Kompetente në Ferizaj.



## Në Gjilan shënohet 22-vjetori i betejës së Zhegocit

GJILAN, 15 PRILL (ER) - Me homazhe te varrezat e dëshmorëve dhe te lapidari në Zhegoc, institucionet komunale të Gjilanit, të udhëhequra nga kryesuesja e Kuvendit, Shpresa Kurteshi-Emini, kanë shënuar të enjten 22-vjetori i betejës së Zhegocit.

Kryesuesja Kurteshi-Emini ka thënë se amaneti i dëshmorëve dhe të rënëve për liri është detyrë për të gjithë ne që të punojmë më shumë dhe ta bëjmë Kosovën shtet me rrugën e fuqishme drejt integritetit euroatlantike. "Ne do të nderojmë në vazhdimësi të gjithë të

rënë për liri. Kujtojmë dhe përulemi para të gjithë të rënëve që nga foshnja e deri te të moshuarit, të cilët dhanë jetën e tyre që ne sot të jetojmë të lirë. Amaneti i dëshmorëve dhe të rënëve për liri është detyrë për të gjithë ne që të punojmë më shumë dhe ta bëjmë Kosovën shtet me rrugën e fuqishme drejt integritetit euroatlantike, zhvillimit ekonomik dhe ndërtimit të sigurisë për të gjithë qytetarët pa dallime", ka thënë kryesuesja Kurteshi-Emini.

Ish-komandanti i UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut, Ahmet Isufi, ka thënë se beteja e

Zhegocit radhitet si një nga betejat më të lavdishme të kësaj zone, e cila ka sjellë ditë të lirisë. Ndërkaq, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Deniza Limani, ka thënë se për shkak të pandemisë Covid-19, nuk kanë mund të organizojnë akademi përkujtimore.

Në betejën e Zhegocit u vranë tetë ushtarë të UÇK-së: Pajazit Ahmeti, Alban Ajeti, Hanumshahe Abdullahu, Tefik Zymberi, Sahit Baftiu, Shahin Baftiu, Kastriot Baftiu, Njazi Osmani, si dhe 18 civilë, ndërsa në fshatin Sllovi u vranë 49 civilë.

## Rrënohet një mbindërtim ilegal në kryeqytet



PRISHTINË, 15 PRILL (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Prishtinë, sektori i ndërtimit, ka rrënuar të enjten një mbindërtim ilegal në lagjen "Bregu i Diellit". "Në rastin në fjalë, qysh prej fillimit të punimeve, inspektori i zonës i ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore, por nuk është përfillur nga pala. Pas shkeljes së vendimit për ndërprerje të punimeve, është nxjer-

rë vendimi për rrënim, me ç'rast pala ka pasur afat disa ditë për ta rrënuar vetë mbindërtimin", ka bërë me dije kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. Ai ka thënë se meqë një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe afati ka kaluar, vendimi është zbatuar nga inspektorët përkatës përmes kompanisë së kontraktuar për rrënim.

## Shpërndahen 300 pako ushqimore për familjet në nevojë në Podujevë

PODUJEVË, 15 PRILL (ER) - Për nder të muajit Ramazan, Komuna e Podujevës ka shpërndarë të enjten mbi 300 pako ushqimore për familjet në nevojë, donacion nga shoqata humanitare "Islamic Relief Kosova".

Nga 300 pakot e dhuruara nga "Islamic Relief Kosova", 200 pako janë shpërndarë për familjet me gjendje të rëndë sociale dhe mbi 100 sosh për familjet me fëmijë jetimë. Pakot ushqimore janë shpërndarë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies

Sociale në bazë të regjistrave që ka kjo për familjet me gjendje të rëndë dhe në asistencë sociale.

Edhe shoqata humanitare "Jetimat e Ballkanit" të mërkurën ka shpërndarë 50 pako ushqimore për familjet skamnore në Podujevë.

Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, me këtë rast ka falënderuar donatorët, duke thënë se me pakot e dhuruara ata kanë kontribuar që në këtë muaj të madhërishtëm sofrat e secilës familje të jenë plot.



Një javë pa më të dashurën tonë




## RABIJE MEXHUANI KASUMI

(1955-2021)

Sot, e dashur nënë, u bënë shtatë ditë pa ty.

U bënë shtatë ditë prej ditës që ta dhamë lamtumirën e fundit, me shpresë, besim dhe dëshirë për t'u parë sërish. Këtë përkujtim, që s' do të doje ta publikonim, mezi e shkruam, se kemi plagë të rëndë dhe të thellë në shpirt, prandaj na kupto, nëno! Megjithatë, u bëmë të gjithë bashkë, e gjitha familja, siç u bëmë bashkë atë ditë që të përcolëm për në botën tjetër, për të të kujtuar, të nderuar dhe për ta ndarë dhimbjen me familjen e ngushtë dhe të gjerë. **Të kujtojnë me mall bashkëshorti Enveri, vajzat Zarifja, Hanifja, Kimetja, Egzona, djali Besimi, nusja Edona, nipat dhe mbesat Anita, Arbnori, Aorta, Liamra, Alea, Auroni, Lina, Pomena, Aniku, Poliana, Liani, Sira dhe dhëndrit Esati, Gëzimi, Berati, Kremtimi. Të pikëlluara familja Kasumi dhe Mexhuani.**



QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Rogova: Drenica e siguron mbijetesën pa 'play-off'

Dardan Rogova është optimist se skuadra kuqezi nga Skenderaj do të sigurojë mbetjen në Superligë edhe pa pasur nevojë të luajë në "play-off". "Besoj që do ta sigurojmë mbijetesën edhe pa 'play-off' pasi, përveç orarit mjaft të mirë, e kemi edhe një skuadër mjaft cilësore për të arritur këtë qëllim", ka thënë Rogova



do të ketë edhe një bisedë me presidentin e klubit. "Kontratë kam edhe për sezonin tjetër po me marrëveshje të dyanshme, por kur të mbarojë kampionati do të ulemi me presidentin dhe të bisedojmë për të ardhmen", ka shtuar sulmuesi gjakovar. Pas 28 xhirove të zhvilluara, Drenica zë vendin e tetë me 30

pikë të grumbulluara. Kjo skuadër ka regjistruar shtatë fitore, nëntë barazime dhe dymbëdhjetë humbje. Dardan Rogova ka një karrierë mjaft të pasur, pasi ka luajtur me sukses të plotë për Vëllaznimin, Besën në Kosovë dhe, gjithashtu, ka përvojë edhe në futbollin e Shqipërisë dhe Turqisë.

## FFK-ja: Nuk do të zgjerohet Liga e Parë

Federata e Futbollit e Kosovës ka mohuar zërat se Komiteti Ekzekutiv i FFK-së e ka diskutuar zgjerimin e mëtejshëm të Ligës së Parë në 24 skuadra për edicionin e ardhshëm, të ndara në dy grupe me nga 12 skuadra. "Një gjë e tillë nuk është diskutuar asnjëherë në KE dhe në asnjë organ tjetër të FFK-së. Shkrimet e tilla po bëhen me qëllim për ta vënë në lajthitje opinionin futbolldashës, e jo klubet sepse ato nuk bien pre e lajmeve të tilla të rrejshme, ngaqë e kanë të ditur formatin e garave në të gjitha ligat", thuhet në njoftimin e FFK-së.

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 15 PRILL - Kampionati elitari i Kosovës në futboll ka hyrë në fazën e fundit dhe gara për titull, por edhe ajo për mbijetesë, po bëhet gjithnjë e më interesante. Skuadra e Drenicës, e cila në këtë edicion po lufton për mbetjen në Superligë, ndeshjen e radhës e zhvillon ndaj Besës së Pejës. Futbollisti Dardan Rogova ka thënë për "Epokën e re" se nga Peja do të rikthehen me tri pikë. "Jemi përgatitur mjaft mirë për ndeshjen e radhës që e kemi ndaj Besës. Kundërshtari ynë është një ekip mjaft i papërshtatshëm pasi që luan pa

presion dhe gjithmonë kundër këtyre ekipeve duhet pasur kujdes, por besoj se do të kthehem me tri pikë", ka deklaruar Rogova.

Lidhur me mbetjen në elitë, Rogova është optimist se skuadra kuqezi do të arrijë këtë sukses pa pasur nevojë të luajë në "play-off". "Besoj se do ta sigurojmë mbijetesën edhe pa 'play-off' pasi, përveç orarit mjaft të mirë, e kemi edhe një skuadër mjaft cilësore për të arritur këtë qëllim", ka thënë Rogova.

Sulmuesi me përvojë nuk e ka përjashtuar mundësinë që edhe në kampionatin e ardhshëm të jetë pjesë e skuadrës nga Skenderaj, por ai konfirmoi se

## Khudo pritet t'i sjellë Kosovës medalje nga Evropiani i Lisbonës



Prishtinë, 15 prill - Kur kanë mbetur edhe 100 ditë deri në hapjen e Lojërave Olimpikë Tokio 2020, ekipi olimpiq i Kosovës në khudo po kërkon medaljet e reja nga Kampionati Evropian i Lisbonës së Portugalisë që mbahet prej 16-18 prill 2021. Për dallim nga Evropiani i vitit të kaluar, i mbajtur në Pragë të Republikës së Çekisë, ku ekipi i khudos u paraqit vetëm me tri xhudiste, shkak i daljes pozitive të xhudistëve të tjerë, në Lisbonë do të paraqiten me gjashtë garues. Distria Krasniqi (-48 kilogramë), Nora Gjakova (-57 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Lorian Kuka (-78 kg), Laura Fazliu (-63 kg) dhe Akil Gjakova (-73 kg) do të synojnë medalje dhe pikë të reja

olimpikë, ndërsa kampionia olimpikë, Majlinda Kelmendi, do të pushojë. Khudo momentalisht qëndron brenda pesë normave olimpikë, të cilat mbeten vetëm për t'u konfirmuar edhe zyrtarisht për Majlindën, Distrian, Norën, Lorianën dhe Akilin. Të gjithë këta qëndrojnë në top-10 të renditjes olimpikë dhe pikët e reja i duhen për ta përmirësuar renditjen. Normën e gjashtë xhudo po e kërkon me Laura Fazliun, e cila momentalisht ndodhet në vendin 50 në renditjen olimpikë të kategorisë -63 kg. Shorti do të hedhet të enjten, ndërsa në ditën e parë të garave (e premte) garojnë Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Flaka Loxha.

## Renditja e UEFA-s, Bayerni vazhdon të jetë në vendin e parë

Nyon, 15 prill - Të mërkurën në mbrëmje u përcaktuan dy çiftet gjysmëfinaliste të Ligës së Kampionëve. PSG - Manchester City dhe Real Madrid - Chelsea, sfida të forta dhe tepër emocionuese. UEFA ka publikuar renditjen e klubeve. Edhe pse u

eliminua nga PSG-ja, Bayern Munchen vazhdon të kryesojë, teksa Barcelona dhe Real Madrid plotësojnë podin. Nëse ia dalin ta eliminojnë Chelsea dhe arrijnë në finalen e madhe që do të zhvillohet në stadiumin "Ataturk Olympic Stadium" të Stambollit (29

maj), Reali do të ngjitet në vend të parë. Në vend të katërt renditet Manchester City, që ndiqet nga Juventus, i vetmi ekip italian në dhjetëshen e parë. Më pas me radhë: Atletico Madrid, PSG, Manchester United, Liverpool dhe Sevilla.



## Hamilton: Dua të qëndroj në F1 edhe kur të mos garoj më

LONDËR, 15 PRILL - Lewis Hamilton, tashmë 36 vjeç, e ndien se është në vitet e fundit të karrierës. Piloti britanik i Mercedesit ka një kontratë me makinën gjermane që skadon në fund të këtij viti, ku në rast se

triumfon, do ta korrë suksesin e tetë kampion bote në Formula 1. Duke folur për të ardhmen, Hamiltoni ka deklaruar: "Pasi të largohem nga garat mund të qëndroj në Formula 1 dhe mendoj se e dëshiroj këtë gjë. Ky sport më

ka dhënë mundësi të njoh shumë njerëz, të jap mesazhe, të inkurajoj njerëz. Por, në një moment do të ndalem. Misioni im është ta bëj këtë sport më përfshirës dhe kjo gjë nuk më shqitet nga mendja. Ky është një problem

që duhet sulmuar që në bazë, duke ndihmuar e mbështetur të rinjtë. Duhet punuar për të pasur më shumë mekanike dhe inxhinierë femra në skuadrat tona, apo persona me ngjyrë", ka shtuar Hamilton.



## Philadelphia triumfon ndaj Brooklynit

Philadelphia, 15 prill - U zhvilluan plot 12 ndeshje gjatë mbrëmjes në NBA dhe pa dyshim vëmendja kryesore ishte te përballja mes dy skuadrave kryesuese të Konferencës së Lindjes. Philadelphia 76ers, e udhëhequr nga Joel Embiid, triumfoi 123-117 ndaj Brooklyn Netsit, me kamerunasin që spikati me plot 39 pikë dhe 13 "rebounde". Ky ishte suksesi i tretë radhazi për Philadelphia, e cila tani kryeson Lindjen me një rekord prej 38 fitoresh dhe 17 humbesh përkundrejt 37 suksesesh dhe 18 disfatash Nets. Diferenca, gjithsesi, mbetet e ngushtë. Në radhët e Netsit, në këtë përballje u ndien mungesat e Kevin Durantit, James Hardenit e LaMarcus Aldridges, pavarësisht se Kyrie Irvingu bëri më të mirën me 37 pikë në total, raporton "Supersport". Ishte, gjithashtu, një mbrëmje magjike për Luka Dončićin. Sloveni shënoi koshin vendimtar në sekondën e fundit në fitoren e Dallas Mavericksit ndaj



### REZULTATET

Minnesota Timberwolves - Milwaukee Bucks	105-130
Charlotte Hornets - Cleveland Cavaliers	90-103
Philadelphia 76ers - Brooklyn Nets	123-117
Toronto Raptors - San Antonio Spurs	117-112
Chicago Bulls - Orlando Magic	106-115
Detroit Pistons - Los Angeles Clippers	98-100
New Orleans Pelicans - New York Knicks	106-116
Houston Rockets - Indiana Pacers	124-132
Oklahoma City Thunder - Golden State Warriors	109-147
Memphis Grizzlies - Dallas Mavericks	113-114
Denver Nuggets - Miami Heat	123-106
Sacramento Kings - Washington Wizards	111-123

Memphis Grizzliesit 114-113. Dončići e mbylli ndeshjen me 29 pikë, por trepikëshi i fundit, duke kërcyer me vetëm një këmbë, magjepsi të pasionuarit e basketbollit. Nuk mund të mungonte me një super

performancë Steph Curry. 42 pikë realizoi "ylli" i Golden State Warriorsit, që kaloi lehtësisht Oklahoma City Thunderin me rezultatin 147-109. "Triple-double" i Draymond Green, autor i 12 pikëve, 16 asistimeve dhe 10 "reboundeve". I pandalshëm Los Angeles Clippersit, që siguroi suksesin e shtatë radhazi në fushën e Detroit Pistonsit. Këtë herë ishte Reggie Jacksoni ai që u dha fitoren kalifornianëve me koshin e realizuar në sekondën e fundit të takimit. Pa Giannis Antetokounmpou, Khris Middleton, autor i 27 pikëve, udhëhoqi Milwaukee Bucksin drejt suksesit kundër Minnesota Timberwolvesit me rezultatin 130-105.

## Muriqi do t'i ketë 'kreditet' e fundit te Lazio

ROMË, 15 PRILL - Përvoja e sulmuesit të Kosovës, Vedat Muriqi në Lazio, deri tash ka qenë zhgënjyese. Sulmuesi "dardan" nuk ka arritur të ambientohet në klubin italian dhe në Serinë A. Deri tash 27-vjeçari i ka realizuar vetëm dy gola, që të dy kundër Atalantas, në Kupë dhe në kampionat. Pra, ky është një bilanc negativ duke e pasur parasysh e "Biancocelesti" kanë pritur shumë më tepër nga ai. Pavarësisht prej mungesës së golave, trajneri Simone Inzaghi vazhdon të besojë te përfaqësuesi i Kosovës. Mirëpo, duket se ish-futbollisti i Fenerbahçes i ka kreditet e fundit në fanellën e kaltër. Sipas mediave italiane, prizrenasit do t'i jepen edhe disa raste para përfundimit të sezonit. Dhe, nëse nuk e tregon veten,



mund të largohet nga kryeqyteti italian. Të dielën që shkoi Muriqi luajti 22 minuta në Verona, ndërsa ndaj Beneventos këtë fundjavë ai mund ta ketë një tjetër mundësi. Immobile e Correa janë favoritë, por trajneri Inzaghi mund t'i

pushojë ata duke e pasur parasysh që Lazio do të luajë më pas me Napolin e Milanin. Në këtë fazë finale të sezonit, Muriqi duhet ta shfrytëzojë çdo mundësi që i vjen. Shpërthimi i tij duhet të vijë që nga ndeshja me Beneventon.

### SHKURT

#### Frankfurti e dëshiron Tarën

Igli Tare nga viti 2009 është pjesë e Lazios si drejtor sportiv, ku ka bërë një punë të shkëlqyer, duke afruar lojtarë të shkëlqyer dhe duke pasuruar arkat e klubit me lëvizjet e bëra në merkato. Duke parë punën shumë të mirë që Tare ka bërë me Lazio, tashmë disa klube duan t'i besojnë atij të njëjtin post. Sipas asaj që raporton "Frankfurter Rundschau", klubi gjerman i Bundesligës, Eintracht Frankfurt, po mendon të emërojë drejtor sportiv shqiptarin. Tare pëlqehet shumë nga gjermanët, të cilët tashmë do të përpiqen ta bindin 47-vjeçar, ndonëse nuk do të jetë e lehtë, pasi kujtojmë se edhe Milani ka pasur kontakte verën e kaluar për ta afruar në klub, por marrëveshja nuk u arrit. Në rast se kjo do të realizohet, atëherë do të ishte një rikthim për Taren në Gjermani, aty ku ka luajtur si futbollist me skuadrat e Kaiserslautern, Dyseldorf, Karlsruherin, Syduleston dhe Manheimin.

#### Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Në mesjavë janë zhvilluar ndeshjet e ndeshjet çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Liverpooli dhe Real Madridi luajtën baras në stadiumin "Anfield" dhe kësaj "Los Blancos" janë kualifikuar në gjysmëfinale. Porto fitoi kundër Chelseas me rezultat 1-0, mirëpo "blutë" arritën të kualifikoheshin pasi kishin shënuar dy gola në Portugali. Manchester City fitoi me rezultat të njëjtë sikurse ndeshja e parë, 2-1, për të fituar me rezultat të përgjithshëm 4-2. Edhe PSG-ja humbi minimalisht ndaj Bayern Munchen por, për shkak të golave të shënuar si mysafir, u kualifikua tutje. Formacioni (4-4-2): Courtois, Valverde, Boateng, Hernandez, Sanusi, Sane, Jorginho, Casemiro, Foden, De Bruyne, Neymar.

#### Qeveria japoneze mendon anulimin e Lojërave Olimpikë

Një funksionar i lartë i Qeverisë së Japonisë ka konfirmuar të enjten se anulimi i Lojërave Olimpikë "Tokio 2020" është ende një opsion i mundshëm. Kjo masë ekstreme mund të merret në sekondën e fundit në rast se numri i infektiveve në këtë vend dhe në gjithë botën do të jetë i lartë. Japonia po përballlet me një valë të katërt të pandemisë Covid-19, teksa numri i personave të infektuar është i lartë. Ndërkohë që, Lojërat Olimpikë nisin pas 100 ditësh. "Nëse do ta kemi të pamundur ta realizojmë këtë Olimpiadë, atëherë do të ndalem", u shpreh Toshihiro Nikai.

#### Klopp: Jemi të trishtuar sepse e duam këtë trofe

Jurgen Klopp zbuloi se janë të trishtuar ndërsa vlerësoi eliminimin e Liverpoolit në Ligën e Kampionëve nga Real Madridi. Kampionët e vitit 2019 u munduan të gjenin një rrugëdalje për Thibaut Courtois në "Anfield" pasi ishte mundur 3-1 në ndeshjen e parë në Valdebebas. Megjithatë, Reali u mbrojti dhe menaxhoi mirë lojën duke u kualifikuar në gjysmëfinale pas barazimit 0-0 në ndeshjen e dytë. "Filluam shumë mirë, por nuk dinim si t'i konkretizojmë shanset tona. Ne mund të kishim kaluar në epërsi shumë herët. Pastaj, çdo minutë që kalonte, bëhej më e vështirë. Ne duhej të fitonim. Kjo është gjithçka, kjo është ajo që duhet të bënim. Tani ne nuk duhet të luajmë të mërkurën dhe ne mund të përqendrohemi në Ligën Premier", ka thënë Klopp. "Jemi të trishtuar sepse e duam këtë trofe. Si trajner, është e vështirë të mos jesh në Ligën e Kampionëve. Ne do të bëjmë gjithçka për t'u kualifikuar për sezonin e ardhshëm", ka shtuar Klopp.

## Zidane: Ende nuk kemi fituar asgjë

Real Madrid barazoi pa gola në "Anfield" kundër Liverpoolit duke siguruar një biletë për në gjysmëfinale. Hera e nëntë në katër ekipet më të mira të turneut më të rëndësishëm për klube në 11 vitet e fundit dhe e 14-ta në

histori për rekordmenët spanjollë të këtij kompeticioni. Një rekord absolut për djemtë e Zidane, teksa në vend të dytë renditen Bayern Munchen dhe Barcelona me nga 12 dalje në gjysmëfinale të turneut prestigjioz. Trajneri i kampionëve

të Spanjës, Zinedine Zidane foli për mediat pas ndeshjes. "E dinim që do na duhej të vuanim dhe ashtu ndodhi, sidomos në 15 minutat e para. Liverpool e nisi shumë mirë ndeshjen. Objektivi ynë ishte kualifikimi dhe ia dolëm,

duke e menaxhuar shumë mirë ndeshjen. Hasëm vështirësi, por mund të jemi krenarë për atë që arritëm. Jemi një grup shumë i bashkuar. Ne jemi gjithmonë gati, pavarësisht asaj që po ndodh dhe mungesave që kemi pasur këtë

periudhë. Unë nuk do të them asgjë. Jemi gjallë në të dyja garat, por nuk kemi fituar asgjë. Kemi pasur komplikime në këtë sezon, natyrisht, por jemi gjallë. Duhet të vazhdojmë kështu", ka thënë Zidane.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosovo/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020, në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

### VAZHDIM I KONKURISIT

**I. Zyrtar për Përkthime 3 (shqip serbisht dhe anasjelltas), dy (2) vende pune**  
Sekretariati i Këshillit Prokurorial, një (1) pozitë  
Prokuroria Themelore Gjakovë, një (1) pozitë

Referenca:	Kodi: KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ- 002
Emri Pozitës:	Zyrtar për Përkthime 3
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ 3
Kodi punës:	IN/140
Grada punës:	12
Raporton tek:	Udhëheqës i Zyrës për Përkthim / Administratori i Prokurorisë
Numri i Pozitave:	Dy (2) pozita
Koeficienti:	Gjashtë (6)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna provuese:	12 muaj
Vendi:	Prishtinë, Gjakovë

**Qëllimi i vendit të punës:**

Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike për stafin Profesional të një njësie organizative në fushën kryesore të punës, për përkthimin e të gjitha materialeve, duke siguruar përkthim cilësor.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Bën përkthim profesional të materialeve të shkruara nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas.  
Bën përkthim profesional simultan në takimet e ndryshme;  
Përgjegjës për respektimin e afateve dhe për saktësinë e përkthimeve që kryen;  
Merr përgjegjësi specifike lidhur me përkthimin e materialeve që kërkohen nga institucioni;  
Është përgjegjës për përkthimin e dokumenteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit të njëjtave;  
Kontrollon/Lektoron materialet e përkthyer dhe është përgjegjës për përkthim cilësor, si me shkrim, konsektiv dhe simultan;  
Mbanë evidencën e saktë e të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, përfshirë përgatitjen e raporteve për tërë punën e kryer;  
Kryen edhe detyra tjera të punës në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**

Shkathtësi të shkëlqyera të njohjes së gjuhës gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim;  
Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Serbe;  
Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**

Diploma e Shkollës së mesme.

**Përvoja e Punës:**

Tri (3) vite përvojë pune.

**II. Asistent për Shërbime të Sigurisë, një (1) vend pune**

Prokuroria Themelore në Prizren

Referenca:	Kodi: KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ- 004
Emri Pozitës:	Asistent për Shërbime të Sigurisë
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Administrativ 3
Kodi punës:	AD/880
Grada punës:	12
Raporton tek:	Administratori i Prokurorisë
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	pesë (5)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna provuese:	12 muaj
Vendi:	Prizren

**Qëllimi i vendit të punës:**

Përgjegjës për sigurinë e objektit dhe personelit.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Përgjegjës për përcjelljen, kontrollimin dhe mënjanimin e mundësisë së shkakimit të rrezikut për objektin dhe personelin e prokurorisë;  
Ofron mbështetje teknike operative për zbatimin e praktikave me të mira të sigurimit.  
Mbanë shënime mbi të gjitha lëvizjet dhe ngjarjet gjatë orarit të punës, duke i vëzhguar dhe ndaluar automjetet e pa autorizuar  
Ruan konfidencialitetin .

Paraqet kërkesat për furnizim ose blerje të materialit të nevojshëm për ndriqim, kamera , mjete të shurjes së zjarrit , libra të evidencës dhe për çdo gjësend tjetër që i ndihmon kryerjen më efikase të punës.

Kujdeset për respektimin e kodeve të mirësjelljes të shërbimit civil.  
Sipas nevojës kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Administratorit.

**Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:**

Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive dhe kryerjen e punës së sigurisë;  
Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi sigurisë,  
Shkathsi të punës dhe menjanimi të suksesshëm të rreziqeve për objekt dhe staf;  
I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;  
Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me te;  
Aftësia për ta kryer punën edhe në kushte të punës nën presion;  
Reagimi duhur në zgjidhjen e problemeve.

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**

Shkolla e Mesme.

**Përvoja e Punës:**

3 vite përvojë pune.

▪ *Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 16.04.2021 deri me datë 22.04.2021 si datë e mbylljes së konkursit.*

▪ *Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)*

▪ *Aplikimi në mënyrë elektronike: Pas plotësimit, aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e skanuara të cilat kërkohen sipas konkursit në formatin PDF, dokumentacioni dërgohet në postën elektronike: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org), ku me pas ju do të pranoni konfirmimin për dërgesën e aplikacionit tuaj në mënyrë elektronike.*

▪ *Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerezore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.*

▪ *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.*

▪ *Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.*

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

- *Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.*

- *Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*

- *"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."*

▪ *Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:*

- *Dëshminë e kualifikimit shkollor;*
- *Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi ose kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);*
- *Dy rekomandime (nëse keni);*
- *Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);*
- *Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;*
- *Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.*

▪ *Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



U skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine, na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 193/2021 od 26. marta 2021. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova objavljuje sledeći:

## P R O D U Ž E N J E K O N K U R S A

### I. Službenik za Prevođenje 3, (albanski – srpski i obrnuto)

Sekretarijat Tužilački Savet Kosova, jedna (1) pozicija  
Osnovno Tužilaštvo Đakovica, jedna (1) pozicija

Referenca: Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ -002  
Naziv pozicije: Službenik za prevodjenje 3,  
Pozicija: Pozicija od karijere  
Nivo: Administrativni nivo 3  
Poslovni Kod: IN/140  
Grada rada: 12  
Raportira kod: Rukovodilac Kancelarija/ Administrator Tužilaštvo  
Broj pozicija: Dve (2) pozicije  
Koeficijent: Šest (6)  
Akt Imenovanja: Na neograničeno  
Probni Rad: 12 meseci  
Mesto: Priština, Đakovica

#### Cilj radnog mesta:

Pružna široku administrativnu i tehničku podršku za Profesionalno osoblje jedne organizativne jedinice iz ključne radne oblasti, za prevođenje svih materijala, obezbeđujući kvalitetan prevod.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

Prevodi za profesionalno i rukovodeće osoblje,  
Obavlja jedan broj važnih specifičnih dužnosti u vezi prevoda materijala, uglavnom postupajući samoinicijativno i bez toga.  
Odgovoran za rokove i tačnosti u svom radu;  
Uzima specifične odgovornosti u vezi materijala koji se zahtevaju od strane institucije;  
Odgovoran je za prevođenje dokumenata i sačuvanje konfidencijalnosti istih  
Obavlja kontrolu prevoda i odgovoran je o kvalitetnom prevodu kako u pismenoj, pismeno formi, tako i simultanom prevodu;  
Vodi tačnu i potpunu evidenciju aktivnosti, dosijea, radova, službenih dokumenata, uključujući pripremu izveštaja o celokupnom obavljenom radu;  
Obavlja i ostale poslove u skladu sa trenutnim zakonima i odredbama koje se mogu zahtevati povremeno na razuman način;

#### Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlične veštine u poznavanju jezika tokom usmenog i pismenog komuniciranja;  
Dobro poznavanje Albanskog i Srpskog jezika u pismenoj formi;  
Poznavanje rada sa kompjuterom (Word i Excel).

#### Stručna sprema i kvalifikacije:

Diploma Srednje Škole.

#### Radno iskustvo:

Tri 3 godine radnog iskustva.

### I. Asistent za Bezbednosne Usluge

Osnovno Tužilaštvo Prizren, jedna (1) pozicija

Referenca: Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ -004  
Naziv pozicije: Službenik za Distribuciju Dokumentata 1  
Pozicija: Pozicija karijere  
Nivo: Administrativno  
Kod rada: AD/880  
Grada: 12  
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo  
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija  
Koeficijent: Pet (5)  
Probni rad: 12 meseci  
Akt imenovanja: Na neodređeno

Mesto: Prizren

#### Cilj radnog mesta:

Odgovoran za sigurnost objekta i osoblja.

#### Glavne obaveze i odgovornosti:

Odgovoran za nadgledanje, kontrolu i uklanjanje mogućnosti izazivanja opasnosti za prostorije i osoblje tužilaštva;  
Pružna operativnu tehničku podršku radi primenu najboljih praksi osiguranja.  
Vodi evidenciju svih kretanja i događaja tokom radnog vremena, posmatrajući i zaustavljajući neovlašćena vozila.  
Održava poverljivost .  
Podnosi zahteve za nabavku ili kupovinu potrebnog materijala za osvetljenje, kamere, aparate za gašenje požara, knjige dokaza i za bilo šta drugo što pomaže u efikasnijem obavljanju posla.  
Stara se o poštovanju kodeksa ponašanja državne službe.  
Po potrebi, obavlja i druge poslove na zahtev Administratora.

#### Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Odgovarajuće znanje za efikasan nadzor i obavljanje poslova obezbeđenja;  
Odlično i sveobuhvatno profesionalno znanje iz oblasti bezbednosti,  
Radne i veštine uspešnog upravljanja rizikom za objekte i osoblje;  
Spreman za rad sa ljudima različitih etničkih grupa i religija;  
